

9.3 PARAQITËSI

Kontrolli i regjistrimeve nga lista e rezultateve të kërkimit, të cilin e mundëson dritarja **Paraqitja – Regjistrimi i njësuar (CONOR)**, funksionon njëjtë si në paraqitësin e regjistrimeve bibliografike. Ndryshimi i vetëm është në vargun e të dhënave në shfaqjen e regjistrimit. Ashtu si në paraqitësin e regjistrimeve bibliografike edhe këtu ekzistojnë tre formate të shfaqjes së regjistrimit.

9.3.1 Formati bazë

Shfaqja në formatin bazë mundëson paraqitjen e regjistrimit në formën e listës së attributeve.

Në formatin bazë paraqiten këto attribute dhe vlerat e tyre:

- numri identifikues (CONOR.XX-ID)
- lloji i pikëqasjes së njësuar
- pikëqasja e njësuar
- shënime për përdoruesin
- variantet e pikëqasjes
- pikëqasjet në lidhshmëri
- e dhëna është në
- e dhëna nuk është në
- përdorimi
- shënimi i përgjithshëm
- gjuha dhe kombësia
- viti i lindjes/fillimit – vdekjes/mbylljes
- kodi i insitucionit/organizatës
- të dhënat për regjistrimin
- URL

9.3.2 Formati MARC

Shfaqja në formatin MARC mundëson paraqitjen e regjistrimit në formën e fushave dhe nënfushave të formatit COMARC/A (shih manualin *COMARC/A*).

Nga fusha e sistemit shfaqen këto të dhëna:

- numri identifikues i regjistrimit ("ID")
- numri lokal i regjistrimit ("LN")
- lloji i maskës
- versioni i regjistrimit
- data e krijimit të regjistrimit dhe emri i personit që e ka krijuar atë

- data e ndryshimeve të fundit në regjistrim dhe emri i personit që ka bërë ndryshimet ("Updated")
- akronimi i bibliotekës që e ka marrë përgjegjësinë për regjistrimin ("Adopted by")



Shembull:

Në paraqitësin e regjistrimeve të njësuara kontrolloni regjistrimin me numër identifikues ID=412774. Nga fusha e sistemit shfaqen të dhënat për regjistrimin:

**ID=412774 LN=000001612 PN V1 18.12.2013 CONAL::BPSH_ALBANAK
Updated: 27.06.2016 CONAL::UTFHF_MARJETAB Copied: 0**

9.3.3 Formati standard

Shfaqja në formatin standard mundëson paraqitjen e regjistrimit në formën, që është në përputhje me GARR (*Guidelines for Authority Records and References*). Elementet e shfaqjes (nëse ekzistojnë) janë të paraqitura në këtë renditje:

- pikëqasja e njësuar
- shënimet nga blloku i shënimeve publike
- variantet e pikëqasjes
- pikëqasjet në lidhshmëri
- shënimet nga blloku i informacioneve për burimin e të dhënave
- numri identifikues (CONOR.XX-ID)